



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.27.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AVOKATIT TË POPULLIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm do të vendos në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga, Mazlumsha Sejfadini (Udhëheqëse Ekipi) dhe Zahir Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	19
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	22

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Avokatin e Popullit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat vjetore financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 25 shtator 2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyrat vjetore financiare të theksuara në memon e planifikimit të auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm është:

Pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar).

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Institucionit të Avokatit të Popullit kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Kontrollat efektive kanë siguruar që menaxhimi i buxhetit të behët në pajtueshmëri me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar.

Progresi i bërë lidhur me adresimin e rekomandimeve, tregon gatishmërinë e menaxhmentit për të përmirësuar në vazhdimësi sistemin e kontrollit të brendshëm, megjithëse kjo nuk është e mjaftueshme në raport me kërkesat e auditimit.

Pavarësisht progresit të bërë, në disa fusha nevojiten përmirësime të mëtutjeshme. Si fusha për përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm të kontrolleve të brendshme mbeten planifikimi dhe realizimi i buxhetit si dhe menaxhimi i procedurave të prokurimit. Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët, kontrolle shtesë nevojiten edhe në procesimin e pagesave.

Rekomandimet tona kryesore janë si në vijim:

Avokati i Popullit duhet të siguroj se:

- Plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar, dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësisë më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Menaxhmenti në baza të rregullta;
- Përgatitja e buxhetit paraprihet nga një proces rigoroz i vlerësimit që pasqyron të gjitha informatat relevante përfshirë realizimet e vitit paraprak dhe ndryshimet e pritura gjatë vitit. Performanca buxhetore të monitorohet në baza mujore dhe barrierat e identifikuara për nivelet e ekzekutimit buxhetor të adresohen me kohë; dhe
- Është bërë një plan i qartë i prokurimit i cili specifikon qartë kërkesat për mallrat dhe shërbimet. Bazuar në këtë plan për të gjitha blerjet mbi vlerën 10,000€, të cilat planifikohen të realizohen brenda vitit, të aplikohen procedurat e hapura të prokurimit.

Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjeturën tonë të auditimit dhe është zotuar se do të adresojnë rekomandimin e dhënë.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) të përgatisë pasqyrat vjetore financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallen deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do ti raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

IAP, ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar)**.

¹ Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF - Nr 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 dhe ndryshim plotësimet e tij; dhe
- Kërkesat e rregullores 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike dhe rregullores të Ministrisë Financave (MF) -nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore (OB-ve).

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrimi

Përveç hartimit të PVF-ve, nga IAP kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet operative (të performancës);
- Draft plani i prokurimit;
- Plani i rrjedhës së parasë së gatshme;
- Raporti mbi obligimet e papaguara; dhe
- Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Te gjitha kërkesat e lartcekura ishin përmbushur me kohë nga IAP-ja.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i IAP-së ka bërë progres të rëndësishëm në adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të vitit 2012. Kjo tregon gatishmërinë e tyre për të adresuar rekomandimet e dhëna. Megjithatë, rekomandimet e pa adresuara ndikojnë në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të IAP-së kishte rezultuar më 14 rekomandime kryesore. IAP kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2013, tetë rekomandime janë adresuar plotësisht; katër janë adresuar pjesërisht, ndërsa dy nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 1 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Pavarësisht përpilimit të planit të veprimit me qëllim të adresimit të rekomandimeve, një pjesë e çështjeve të rëndësishme ende nuk janë implementuar. Këto rekomandime të pa adresuara ndërlidhen me fushat, si: planifikimi dhe ekzekutimi, përfshirë edhe donacionet e jashtme dhe prokurimin.

Rreziku Dështimi për t'i adresuar rekomandimet mbi sistemet kyçe financiare mund të rezultojë në:

- Dobësi të vazhdueshme në ekzekutimin e buxhetit;
- Dobësi në evidentimin e vonesave në përmbushjen e kontratave; dhe
- Kontrolle të dobëta në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Rekomandimi 1 Avokati i Popullit duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar, dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Menaxhmenti në baza të rregullta.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe të rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

Menaxhmenti i IAP-së kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Kontrollet efektive kanë siguruar që menaxhimi i buxhetit të behët në pajtueshmëri me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar.

Progresi i bërë lidhur me adresimin e rekomandimeve, tregon gatishmërinë e menaxhmentit për të përmirësuar në vazhdimësi sistemin e kontrollit të brendshëm, megjithëse kjo nuk është e mjaftueshme në raport me kërkesat e auditimit.

Pavarësisht progresit të bërë, në disa fusha nevojiten përmirësime të mëtutjeshme. Si fusha për përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm të kontrolleve të brendshme mbeten planifikimi dhe realizimi i buxhetit si dhe menaxhimi i procedurave të prokurimit. Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët, kontrolle shtesë nevojiten edhe në procesimin e pagesave.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për IAP, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e arkëtuara nga donacionet e jashtme.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	968,039	914,623	749,747	638,270	596,954
Granti i Qeverisë -Buxheti	968,039	890,289	738,988	625,390	535,946
Donacionet e vendit	-	-	-	-	2,981
Donacionet e jashtme	-	24,334	10,759	12,880	58,027

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar është më i ulët 53,416€. Ky ndryshim paraqitet si rezultat i shkurtimit të buxhetit nga Ministria e Financave (MF) për 77,750€³ dhe pranimit të donacioneve për 24,334€ (për më tepër shiko kapitullin 4.4 Donacionet e jashtme).

Në vitin 2013, IAP, ka përdorur 82% të buxhet final ose 749,747€, me një nën realizim prej 9% krahasuar me vitin 2012 (buxheti ishte shpenzuar 91%).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	968,039	914,623	749,747	638,270	596,953
Pagat dhe Mëditjet	526,050	513,050	450,249	372,940	323,853
Mallrat dhe Shërbimet	359,239	326,573	267,658	246,616	260,574
Shërbimet komunale	30,000	23,000	17,410	18,714	12,526
Subvencionet dhe Transferet	-	-	-	-	-
Investimet Kapitale	52,750	52,000	14,430	-	-

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

³ Për arsye se IAP në përfundim të tremujorit kishte nën-shpenzim të buxhetit krahasuar me planin e rrjedhës së parasë së gatshme, MF kishte reduktuar buxhetin për vlerën prej 77,750€ (paga dhe mëditje, 13,000€; mallra dhe shërbime 40,000€; investime kapitale 17,750€ dhe shërbime komunale 7,000€) - shkresa 117/10 tetor 2013.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Të kategoria paga dhe mëditje, buxheti final ishte shkurtuar për 13,000€. Edhe përpos shkurtimit të buxhetit realizimi në 88% tregon nivel të ulët të realizimit;
- Kategoria mallra dhe shërbime me buxhet final ishte reduktuar për 32,666€. Edhe përkundër kësaj një pjesë e konsiderueshme e buxhetit kishte mbetur e pashpenzuar;
- Të kategoria shërbimeve komunale buxheti final ishte shkurtuar për 7,000€. Edhe përpos shkurtimit të buxhetit në këtë kategori janë shpenzuar vetëm 76% të buxhetit; dhe
- Buxheti i kategorisë për investime kapitale ishte realizuar vetëm 28%. Këtë e kanë shkaktuar mungesa e realizimit të disa projekteve. Projekti për blerje të pajisjeve të teknologjisë informative në vlerë 12,750€ nuk ishte realizuar. Po ashtu edhe projekti për blerje të dy automjeteve në vlerë prej 57,000€ ishte realizuar pjesërisht. Njëri lot ishte realizuar me blerjen e një automjeti në vlerë 14,430€, ndërsa tjetri ishte anuluar.

Çështja 2 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i lartë

E gjetura	Ekzekutimit i buxhetit në shumicën e kategorive ishte joadekuate. Shprehur në përqindje kjo është me e shprehur në kategorinë e investimeve kapitale me 28%.
Rreziku	Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i ulët i buxhetit mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.
Rekomandimi 2	Avokati i Popullit duhet të siguroj se përgatitja e buxhetit paraprihet nga një proces rigoroz i vlerësimit që pasqyron të gjitha informatat relevante përfshirë realizimet e vitit paraprak dhe ndryshimet e pritura gjatë vitit. Performanca buxhetore të monitorohet në baza mujore dhe barrierat e identifikuar për nivelet e ekzekutimit buxhetor të adresohen me kohë.

4.3 Donacionet e jashtme

Përshkrimi

Buxheti final i donacioneve për IAP-në, për vitin 2013 ishte 24,334€. Burimi i këtyre mjeteve ishte nga katër donacione të jashtme. Këto janë prezantuar në tabelën në vijim:

Tabela 3. Donacionet e jashtme (në €)

Nr.	Përshkrimi	Donacioni ne dispozicion	Kthimet e donacioneve	Buxheti final i donacioneve	Shpenzimi 2013	në %
1	Save the children	7,056	2,950	4,106	4,106	58%
2	Qeveria norvegjeze	1,029		1,029	-	-
3	Qeveria turke	2,374		2,374	-	-
4	Qeveria belge	16,825		16,825	6,653	40%
Totali		27,284	2,950	24,334	10,759	39%

Realizimi i donacioneve në shkallën 39% tregon që IAP nuk i ka shfrytëzuar burimet financiare në mënyrë efikase. Donacioni "Save the children" ishte shpenzuar në vlerë 4,106€ apo 58%, ndërsa mjetet e pashpenzuar në vlerë 2,950€ ishin kthyer të donatori. Po ashtu edhe donacioni nga Qeveria Belge ishte realizuar në nivel mjaft të ulët (40%).

Çështja 3 - Shfrytëzimi i ulët i fondeve të donacioneve - Prioritet i mesëm

E gjetura IAP edhe këtë vit nuk ka shpenzuar të gjitha mjetet në dispozicion nga donacionet edhe përkundër rekomandimeve të dhëna nga vitet e mëhershme. Shqetësuese është mos shfrytëzimi i donacionit turk dhe norvegjez të mbetur nga viti paraprak.

Rreziku Shfrytëzimi i ulët i donacioneve ulë efektivitetin e veprimtarisë së IAP-së, si dhe mund të ketë ndikim edhe në uljen e besueshmërisë të donatorëve për vitet vijuese.

Rekomandimi 3 Avokati i Popullit duhet të siguroj se me rastin e hartimit të planit buxhetor, fondet buxhetore nga donacionet janë të harmonizuara me koston e përafërt të projekteve, si dhe të bëhet një plan i qartë kohor për fillimin e shfrytëzimit të tyre.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

IAP, kishte përgatitur dhe dorëzuar planin e prokurimit në Autoritetin Qendror të Prokurimit. Sipas regjistrit të kontratave të nënshkruara ishin 23 kontrata në vlerë 88,058€. Në 19 aktiviteteve të prokurimit kishte aplikuar procedurën e kuotimit të çmimit dhe vlerës minimale e cila tregon mos respektimin e transparencës dhe konkurrencës në shpenzimin e parasë publike.

Për të testuar pajtueshmërinë me kornizën ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), ne kemi marrë si mostër tri kontrata nga kategoria mallra dhe shërbime dhe një nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë të përgjithshme prej 41,393€. Po ashtu kemi testuar edhe 25 pagesa nga mallrat dhe shërbimet në vlerë 52,414€.

Bazuar në këtë vërejtëm çështjet si në vijim:

Çështja 4 - Shmangie nga procedurat e hapura- Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Nga shqyrtimi i dokumentacionit ne kemi identifikuar se IAP në vitin 2013, me qëllim të shmangies së procedurave të hapura kishte bërë ndarjen e tenderëve. Për tu furnizuar me material shpenzues për zyre kishte lidhur dy kontrata, e para ishte nënshkruar në muajin mars në vlerë prej 9,525€ dhe e dyta në muajin dhjetor në vlerë 6,783€. |
| Rreziku | Mos ndjekja e procedurave të duhura të prokurimit dhe udhëzuesve përkatës mund të shkaktoj humbje financiare për IAP, duke paguar çmime me të larta në raport me çmimet e tregut. |
| Rekomandimi 4 | Avokati i Popullit duhet të siguroj se do të bëhet një plan prokurimi i cili specifikon qartë kërkesat për mallrat dhe shërbimet. Bazuar në këtë plan për të gjitha blerjet mbi vlerën 10,000€, të cilat planifikohen të realizohen brenda vitit, të aplikohen procedurat e hapura të prokurimit. |

Çështja 5 - Vonesa në procesimin e pagesave - Prioritet i mesëm

E gjetura Të gjitha faturat e pranuar duhet të paguhen brenda 30 ditëve (Rr.Fin.01/2013 - neni 37). Në disa pagesa, nuk kishte kontrolle të duhura në procesimin e lendeve për pagesë, përkatësisht kishte vonesa në ekzekutimin e tyre. Kjo është shpalosur të rastet në vijim:

- Shpenzimet në vlerë 754€, për punëtorinë e mbajtur në muajin prill, fatura ishte bërë me datë 27.04.2013, ndërsa pagesa nuk ishte realizuar deri në fund të muajit dhjetor 2013, me shtatë muaj vonesë; dhe
- Shpenzimet për blerje të automjetit në vlerë prej 14,430€ ishte paguar me 14 ditë vonesë. Fatura ishte pranuar më datë 28.10.2013, ndërsa ishte procesuar për pagesë më datën 12.12.2013.

Rreziku Dështimi për të ndjekur me konsistencë procedimin e pagesave dhe rregullat përkatëse mund të pasojë më vonesa në pagimin e faturave dhe të mbesin obligime për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi 5 Avokati i Popullit duhet të shqyrtojë pse faturat nuk janë paguar brenda afatit të parashikuar dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar që të gjitha faturat procesohen me kohë për pagesë.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Për blerjet të cilat nuk procesohen përmes procedurave të prokurimit ne kemi testuar 20 pagesa në vlerë 23,332€. Këto pagesa ishin bërë për furnizime/shërbime të ndryshme (komunali, shpenzime të udhëtimit dhe mbushje të telefonisë mobile). Ne kemi vërejtur se IAP nuk ka kontrolle funksionale në menaxhimin e shpenzimeve të telefonisë mobile.

Çështja 6 - Shfrytëzimi i shërbimeve të telefonisë mobile pa kontratë - Prioriteti i mesëm

E gjetura IAP shfrytëzon kartela mbushëse nga operatori i telefonisë mobile “Vala” me të cilin nuk kishte kontratë. Deri në fund të muajit tetor, kartelat mbushëse janë shpërndarë bazuar në Vendimin 26.01.2011 sipas të cilit të punësuarit kishin shfrytëzuar kartela mbushëse nga 15€ deri në 250€ varësisht sipas pozitive. Ndërsa më 31 tetor 2013 është nxjerrë vendim i ri për shpenzimet e telefonisë mobile në të cilin ishin ulur tarifat (10€ deri në 70€). Për vitin 2013 për mbushje të telefonisë mobile ishin shpenzuar 21,140€.

Rreziku Mënyra aktuale e furnizimit me mbushje të telefonisë mobile rrezikon që kostoja për shërbimet e njëjta të jetë me e lartë në raport me mundësitë që ofron tregu.

Rekomandimi 6 Avokati i Popullit duhet të shqyrtojë mundësinë që përmes procesit të rregullt të prokurimit të kontraktoj shërbimet e telefonit. Kjo do të siguroj shërbime me cilësore me kosto më të ulët.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Për vitin 2013 buxheti final për paga dhe mëditje ishte shpenzuar 450,248€ apo 88%. Numri i pozitive të aprovuara ishte 55, ndërsa numri aktual i punëtorëve në fund të vitit ishte 51.

Ne testuam listat e pagave për muajin janar dhe dhjetor, përfshirë edhe pagat shtesë për 19 zyrtarë si dhe pesë dosje të personelit. IAP në muajin dhjetor kishte paguar pagat bruto në vlerë 5,462€ për Drejtorin e administratës i cili ishte rikthyer në punë me vendim të gjykatës.

IAP kishte procesuar pagat në pajtim me kontratat e punës dhe legjislacionin në fuqi. Po ashtu pagesat për pagat shtesë, pranimet e të punësuarve në punë, si dhe zyrtarët që e kishin lëshuar punën ishin aprovuar nga personeli përgjegjës.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Sipas regjistrimit kontabël (SIMFK) lista e pasurive të IAP-së përmban një vlerë neto prej 23,246€, ndërsa pasuria jo-kapitale me vlerë nën 1,000€ është 61,000€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës së pasurisë janë mbajtur në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të OB-ve.

Në regjistrin kontabël ishin regjistruar pajisjet e teknologjisë informative (kompjuter server HP DI 360G7) të pranuar si donacion nga OSCE në vlerë prej 6,760€ si dhe automjeti i blerë në vlerë prej 14,430€. Po ashtu nga regjistri kontabël ishte ç' regjistruar automjeti- kombi H1, viti i prodhimit 2004, të cilin IAP ja kishte dhuruar OJQ " SOS fshatrat e Fëmijëve " Prishtinë.

Bazuar në këtë, ne kemi konstatuar se IAP, kishte menaxhuar pasuritë e veta në përputhje kornizën ligjore në fuqi dhe praktikën e mira menaxheriale. Në fund të vitit kishte kryer edhe inventarizimin e pasurisë.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrimi

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2013 ishte në shumë 526€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014. Pagesa e faturave nuk ishte kryer pasi që faturat ishin pranuar me vonësë.

IAP, në vitin 2013 ka raportuar obligime të papaguara në pajtim me kërkesat e rregullores financiare nr. 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore (OB) dhe në pajtim me Rregulloren MF - Nr 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në përgjithësi.

Në përfundim të vitit 2013, IAP kishte rekrutuar një zyrtar në pozitën e Auditorit të brendshëm (AB). Në këtë periudhë AB kishte përgatitur planin strategjik (2014-2016) dhe planin vjetor të auditimit për vitin 2014, i cili ishte miratuar nga Drejtori ekzekutiv i IAP-së. Me tutje, AB kishte filluar të ndjek trajnimet e organizuara nga Njësia Qendrore Auditimit të Brendshëm në kuadër të MF-së.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit Të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Menaxhmenti duhet të siguroj që plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve tona është rishikuar së bashku me pjesëmarrësit në zingjirin llogaridhënes me qëllim të përcaktimit të veprimeve korigjuese.		IAP kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet, megjithatë në fund të vitit 2013 kishin mbetur disa rekomandime të pa adresuara.	
4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Menaxhmenti duhet të sigurojë që projektet e planifikuara me buxhet janë realizuar për arritjen e objektivave të IAP-së.			Nuk janë marrë masa.
4.3 Kërkesat e raportimit	Menaxhmenti ka ndërmarrë veprime adekuate për të siguruar që në planin e prokurimit janë të përfshira të gjitha aktivitetet që kërkojnë procedura të prokurimit.	Po		
4.3 Kërkesat e raportimit	Të analizoj arsyen e përsëritjes së lëshimeve dhe të ndërmarr masa adekuate që PNF e ardhshme të përgatiten në pajtim me kërkesat ligjore për raportim financiar.	Po		
4.4 Donacionet e jashtme	Të riadresohet çështja e donacioneve duke riorganizuar mënyrën e menaxhimit të tyre.			Nuk janë marrë masa.

4.5.1 Prokurimi	Menaxhmenti duhet të kryej analiza të plota dhe gjithëpërfshirëse të nevojave për të siguruar transparencë të plotë dhe inkurajim të të gjithë furnizuesve në mënyrën më efikase dhe efektive.		Në vitin 2012, pothuajse në të gjitha rastet janë aplikuar procedurat me kuotim të çmimeve, ndërsa në vitin 2013, menaxhmenti ka ndërmarre masa dhe ka filluar të aplikoj procedura të hapura për një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve.	
4.5.1 Prokurimi	Menaxhmenti i IAP-se ka rishikuar linjën e komunikimit mes departameneve me qëllim të evitimit të ndarjes së kërkesave të prokurimit që janë kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura.		Menaxhmenti ka ndërmarrë masa për të menaxhuar shpenzimet me procedura të hapura të prokurimit, megjithatë edhe në vitin 2013 identifikuam një rast në të cilin kishte ndarje të tenderit për të shmangur procedurat e hapura.	
4.5.1 Prokurimi	Të rris kontrollet e monitorimit për të siguruar që shërbimet janë kryer sipas afateve kohore të përcaktuara në kontratë.	Po		
4.5.1 Prokurimi	Të siguroj që zyrtarët përkatës kanë nënshkruar DNKDF-në përmes së cilit do të aprovohej inicimi i blerjes, sigurimi i fondeve dhe klasifikimi adekuat i kodeve ekonomike.	Po		
4.5.1 Prokurimi	Shtimi i kontrolleve në sektorin e pagesave për të siguruar shfrytëzimin e të gjitha alternativave ligjore për procesimin e pagesave nga kategoria dhe kodet ekonomike adekuate.	Po		

4.5.3 Pagat dhe mëditjet	Ka bërë përshtatjen e titujve të pozitive në listën pagave me ato në Akt emërim.		IAP kishte kërkuar nga MAP-i rregullimin e kësaj çështje mirëpo sipas MAP-it kjo do të rregullohet me zbatimin e Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullores për Klasifikimin e vendeve të punës.	
4.5.3 Pagat dhe mëditjet	Të inicioj procedurat për rekrutimin e Drejtorit të Hetimeve.	Po		
4.6.2 Paraja e gatshme	Të forcoj kontrollet në menaxhimin e parasë së gatshme duke aprovuar vetëm ato shpenzime të pa planifikuara. Aty kur është e mundur të shqyrtoj mundësin për kryerjen e pagesës për shpenzime të reprezentacionit në formë të transferit tek furnitori.	Po		
5. Sistemi i auditimit të brendshëm	Ka marr në konsideratë nënshkrimin e marrëveshjes me KPM-në për shfrytëzimin e shërbimeve të përbashkëta të auditimit të brendshëm me qëllim të definimit të detyrave, përgjegjësi dhe mënyrën e pagesës.	Po		